

**VENDIM**  
**Nr. 573, datë 3.10.2018**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE NË USHTRIMIN E  
FUNKSIONEVE MBIKËQYRËSE NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR TË  
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ENERGJINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 100, pika 1, e 116, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. Qëllimi**

Qëllimi i këtij vendimi është:

- Përcaktimi i rregullave dhe procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror në ministrinë përgjegjëse për energjinë, në përmbushje të detyrimit për të garantuar ndërtimin, përdorimin e sigurt dhe respektimin e rregullave teknike përkatëse të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror dhe lidhjen e saj në kuadër rajonal;
- Garantimi i një furnizimi të qëndrueshëm e të sigurt me gaz natyror, nëpërmjet një tregu konkurrues dhe të liberalizuar;
- Mbështetja dhe mbrojtja e mjedisit, duke aplikuar vlerësime e procedura të njëjta për të licencuarit dhe operatorët e tjerë në sektorin e gazit natyror, përfshirë edhe linjat direkte, në rastet e vendosjes së penalteteve për shkelje të mundshme të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me zbatimin dhe respektimin e rregullave e të standardeve teknike në shfrytëzimin e infrastrukturës dhe të instalimeve të gazit.

**II. Përcaktimi i rolit të ministrisë në realizimin e mbikëqyrjes e të inspektimit në aktivitetet, instalimet dhe pajisjet e sektorit të gazit natyror**

1. Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, në aktivitetet, instalimet dhe pajisjet e sektorit të gazit natyror kryhet nga ministria përgjegjëse për energjinë, me përjashtim të akteve dhe kompetencave rregullatore të Entit Rregullator të Energjisë.

2. Ministria e realizon funksionin e saj mbikëqyrës nëpërmjet strukturave të saj përgjegjëse për sektorin e gazit, që janë: struktura që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit në ministri dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin.

Marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit në ministri, dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.

3. Ministria mbikëqyr zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, për sa u përket zbatimit të rregullave teknike, procedurave, kushteve e standardeve në fuqi në aktivitetet për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës, të instalimeve e pajisjeve të sektorit të gazit, të cilat realizohen nga shoqëritë që kryejnë veprimtari në sektorin e gazit natyror.

4. Inspektimi, në funksion të mbikëqyrjes në aktivitetet e ndërtimit e të operimit të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, që kryhen nga shoqëritë e gazit natyror, për zbatimin e rregullave teknike dhe të procedurave përkatëse, specifikimeve teknike dhe normave të cilësisë, realizohet jo më shpesh se një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ka informacion për situata që paraqesin rrezikshmëri për pajisjet e instalimet dhe për jetën e njerëzve e të pronës së tyre.

5. Aktivitetet e mbikëqyrjes dhe të inspektimit në sektorin e gazit natyror mund të kryhen vetëm nga persona që kanë arsimin përkatës, janë të pajisur me certifikatën e lejes profesionale përkatëse, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve

dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, dhe disponojnë kartën e identifikimit si punonjës të ministrisë përgjegjëse për sektorin e energjisë apo të inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror.

6. Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë përcakton formën dhe përmbajtjen e certifikatës së lejes profesionale përkatëse, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, si dhe miraton kartën e identifikimit për inspektorin që kryen inspektim në sektorin e gazit.

### **III. Mbikëqyrja dhe inspektimi në ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, si dhe në operatorët që kryejnë veprimtari në sektorin e gazit natyror**

1. Mbikëqyrja dhe inspektimi mbulojnë zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, rregulloret, rregullat teknike dhe procedurat përkatëse, të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me kryerjen e aktivitetit të gazit, projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e objekteve të gazit, të pajisjeve e linjave, përfshirë edhe linjat direkte, si dhe mbikëqyrjen e cilësisë së gazit të shpërndarë për konsumatorët.

2. Ministria do të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në operatorin e transmetimit të gazit natyror për përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Përcaktimin e kushteve tekniko-teknologjike për lidhjen e objekteve të transportit të gazit, të pajisjeve dhe impianteve;

b) Hermetizimin dhe mbajtjen e presionit të gazit natyror;

c) Operimin e sistemit të transportit të gazit natyror;

ç) Koordinimin e operacioneve në terren, mbi bazën e një rregulloreje të miratuar nga ministri;

d) Monitorimin e disponueshmërisë teknike e funksionale të transportit, duke përfshirë programin kohor për modernizimin e sistemit të transportit;

dh) Sigurimin e sistemit të transportit për dëmet që mund të shkaktohen në palët e treta;

e) Përdorimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të monitorimit e të operimit të sistemit të gazit natyror, në zbatim të rregullave dhe standardeve në fuqi;

ë) Kryerjen e kontrollit teknik në instalimet e transmetimit, në përputhje me rregullat teknike dhe Kodin e Rrjetit, që u referohet ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të instalimeve.

3. Ministria do të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në operatorin e shpërndarjes së gazit natyror për përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Përcaktimin e kushteve tekniko-teknologjike për lidhjen e objekteve të shpërndarjes së gazit, të pajisjeve dhe impianteve;

b) Hermetizimin dhe mbajtjen e presionit të gazit;

c) Operimin e sistemit të shpërndarjes së gazit natyror;

ç) Respektimin e parimit të transparencës dhe mungesës së diskriminimit në sistemet e tubacioneve dhe sistemit të informacionit në infrastrukturën e shpërndarjes së gazit natyror;

d) Shpërndarjen e sigurt të gazit natyror;

dh) Funksionimin, mirëmbajtjen dhe modernizimin e sistemit të shpërndarjes;

e) Zbatimin e rregullave e të standardeve në veprimtarinë që kryen;

ë) Kryerjen e kontrollit teknik në instalimet e shpërndarjes, në përputhje me rregullat teknike dhe Kodin e Rrjetit, që u referohet ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të instalimeve.

4. Ministria do të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në operatorin e magazinimit të gazit natyror për përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Presionin dhe kontrollin e sasisë në dy ciklet e punës;

b) Funksionimin e magazinave të gazit natyror;

- c) Koordinimin e operacioneve në terren me operatorin e sistemit të transportit;
- ç) Monitorimin dhe sigurimin e disponueshmë-risë funksionale të sipërfaqes dhe pjesës nëntokësore të ruajtjes së gazit;
- d) Respektimin e kodit në operacionet për qasjen e palëve të treta në kapacitetet magazinuese;
- dh) Shfrytëzimin racional të kapacitetit magazinues;
- e) Kryerjen e kontrollit teknik në depozitat e magazinimit nëntokësor të gazit natyror, në përputhje me rregullat teknike që u referohen ndërtimit, mirëmbajtjes dhe përdorimit të instalimeve.

5. Ministria do të ushtrojë funksionin mbikëqyrës në operatorin e terminalit të gazit natyror të lëngëzuar për përgjegjësitë e mëposhtme:

- a) Funksionimin e depozitave e të instalimeve të ngarkim-shkarkimit dhe gazifikimit të gazit natyror të lëngëzuar;
- b) Presionin dhe kontrollin e sasisë në dy ciklet e punës;
- c) Koordinimin e operacioneve në terren me operatorin e sistemit të transportit;
- ç) Monitorimin dhe sigurimin e disponueshmë-risë funksionale të depozitave dhe infrastrukturës bregdetare të ngarkimit e shkarkimit të gazit natyror të lëngëzuar;
- d) Respektimin e kodit në operacionet për qasjen e palëve të treta në kapacitetet depozituese dhe të ngarkim-shkarkimit;
- dh) Shfrytëzimin racional të kapacitetit të terminalit të gazit natyror të lëngëzuar;
- e) Kryerjen e kontrollit teknik në terminalin dhe instalimet bregdetare të gazit natyror të lëngëzuar, në përputhje me rregullat teknike që u referohen ndërtimit, mirëmbajtjes e përdorimit të terminalit dhe instalimet bregdetare të gazit natyror të lëngëzuar.

#### **IV. Procedurat në realizimin e funksionit mbikëqyrës të ministrisë dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror**

1. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, ministria dhe/ ose inspektorati shtetëror përgjegjës për gazin, nëpërmjet kryeinspektorit, zbatojnë procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Në rastet kur parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara, që janë identifikuar gjatë mbikëqyrjes së shoqërive që kryejnë veprimtari gazi të rregulluara, nuk janë eliminuar brenda afatit të përcaktuar, ministria i kërkon Entit Rregullator të Energjisë që të fillojë procedurën për heqjen e licencës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

3. Ministri, në bashkëpunim me ministrat e tjerë, urdhëron kryerjen e inspektimeve të kombinuara, në rastet kur:

- a) Është e nevojshme për të eliminuar një rrezik të menjëhershëm për jetën, shëndetin dhe pronën e qytetarëve;
- b) Është e nevojshme të merren masa urgjente, që nuk mund të shtyhen;
- c) Është e nevojshme, për shkak të kompleksitetit të mbikëqyrjes apo për rëndësinë e eliminimit të defekteve;
- ç) Është e nevojshme për të kryer auditimin e shoqërive të gazit;
- d) Konsiderohet se mbikëqyrja e kombinuar mund të kryhet më shpejt dhe me kosto më të ulët për të dyja palët, që janë subjekt i mbikëqyrjes dhe i kontrollit të inspektorëve;
- dh) Është e nevojshme që të rishqyrtohen përfundimet e një inspektimi apo çdo nisme ose ankese të bërë për çështje që janë në kompetencë të autoriteteve të inspektimit.

#### **V. Roli dhe përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse për sektorin e gazit në ministri në mbikëqyrjen dhe inspektimin e ndërtimit e të operimit të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, si dhe të subjekteve që kryejnë aktivitet në sektorin e gazit natyror**

1. Struktura përgjegjëse për sektorin e gazit në ministri kryen mbikëqyrje në subjektet dhe personat që kanë të bëjnë me kryerjen e aktivitetit të gazit: projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e objekteve të gazit, të pajisjeve e linjave, përfshirë edhe linjat direkte, si dhe mbikëqyrjen e cilësisë së gazit

të shpërndarë për konsumatorët, në lidhje me zbatimin e rregulloreve e akteve, për rregullat teknike dhe procedurat përkatëse në objektet dhe instalimet që shërbejnë për transportin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi dhe rregulloret përkatëse, të miratuara nga organet përkatëse, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. Objekti i mbikëqyrjes dhe inspektimit përfshin zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë vendim, në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, aktet nënligjore, rregullat teknike dhe procedurat përkatëse, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, si dhe specifikimet teknike dhe normat e cilësisë, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit.

3. Gjatë mbikëqyrjes, nëpunësit shtetërorë të njësisë përgjegjëse për sektorin e gazit, për kryerjen e detyrave të caktuara, mund të angazhojnë ekspertë nga organet dhe institucionet që kanë kualifikimin dhe eksperiencën e duhur në aktivitetin për projektimin, ndërtimin dhe operimin e linjave e të instalimeve të sektorit të gazit natyror.

#### **VI. Roli dhe përgjegjësitë e inspektoratit shtetëror, përgjegjës për sektorin e gazit, nën mbikëqyrjen dhe inspektimin e ndërtimit e të operimit të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, si dhe të subjekteve që kryejnë aktivitet në sektorin e gazit natyror**

1. Inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit kryen inspektimin e objekteve për transportin, shpërndarjen dhe depozitimin e gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, por edhe të objekteve të tjera të gazit, nëpërmjet lëshimit të një urdhri inspektimi dhe në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe të rregullores së miratuar nga ministri.

2. Objekti i këtij inspektimi përfshin zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë vendim, të akteve nënligjore për rregullat teknike përkatëse, në lidhje me performancën e veprimtarive të gazit nga ana e subjekteve që kryejnë veprimtari gazi, subjekteve të sektorit publik dhe shfrytëzuesve të sistemit të gazit.

3. Kushtet, procedurat për vendosjen e gjobave dhe masa konkrete për çdo shkelje zbatohen në përputhje me pikën 3, të nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri.

4. Gjatë inspektimit, inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, për kryerjen e detyrave të caktuara mund të angazhojë ekspertë nga organet dhe institucionet e tjera, që kanë kualifikimin dhe eksperiencën e duhur në aktivitetin për projektimin, ndërtimin dhe operimin e linjave e të instalimeve të sektorit të gazit natyror.

#### **VII. Të drejtat dhe detyrimet e inspektorit për inspektim në sektorin e gazit natyror**

1. Inspektori në sektorin e gazit kryen inspektim të objekteve për transportin, shpërndarjen dhe depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar e të objekteve të tjera të gazit natyror, në përputhje me autoritetin që u jepet sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. Inspektori për sektorin e gazit natyror kryen, gjithashtu, inspektimin e objekteve e të instalimeve të sektorit të gazit, në rastet e parashikuara nga ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe nga ky vendim.

3. Inspektori për sektorin e gazit natyror ka të drejtë dhe është i detyruar që, në proceset dhe aktivitetet e këtij sektori të inspektojë:

a) Nëse leja e ndërtimit dhe e operimit të infrastrukturës së gazit natyror është marrë në pajtim me nenin 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”;

b) Nëse miratimi i organit përkatës për punimet ndërtimore është përfituar në përputhje me legjislacionin për objektet e ndërtimit;

c) Nëse është përgatitur dokumentacioni teknik për vendosjen e pajisjeve dhe instalimeve të gazit;  
ç) Nëse instalimi dhe testimi i pajisjeve të gazit është kryer në përputhje me ligjin dhe rregullat teknike përkatëse;

d) Nëse subjektet në sektorin e gazit, në funksionimin e tyre, plotësojnë kushtet e përcaktuara nga ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, në lidhje me kryerjen e këtyre veprimtarive;

dh) Nëse instalimet në sektorin e gazit mbahen brenda parametrave teknikë gjatë funksionimit të tyre dhe janë të kontrolluara rregullisht e të testuara në përputhje me rregullat teknike dhe standardet;

e) Nëse personat që veprojnë në instalimet e gazit dhe personat që punojnë në mirëmbajtjen e tyre plotësojnë kushtet e përcaktuara për këto veprimtari dhe kanë dëshmitë përkatëse;

ë) Nëse cilësia e gazit natyror të furnizuar është në përputhje me standardet e miratuara.

4. Inspektori nuk mund të marrë pjesë në përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe në kryerjen e kontrollit teknik të dokumentacionit teknik për objektet, për të cilat ai/ajo është përgjegjës për kryerjen e inspektimit, nuk mund të marrë pjesë në punimet në objektet në të cilat ai/ajo do të kryejë inspektime dhe nuk mund të kryejë mbikëqyrjen e ekspertëve për veprat në objektet në të cilat ai/ajo kryen inspektimin.

### **VIII. Autorizimi i inspektimeve**

Autorizimi i inspektimeve për mbikëqyrjen dhe inspektimin e aktiviteteve të ndërtimit e të operimit të infrastrukturës në sektorin e gazit natyror, si dhe të subjekteve që operojnë në sektorin e gazit natyror realizohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të këtij vendimi.

**IX. Detyrimet e subjekteve që ndërtojnë e shfrytëzojnë infrastrukturën në sektorin e gazit natyror dhe janë operatorë në transmetimin, shpërndarjen e depozitimin nëntokësor të gazit natyror, si dhe në терминаlet e gazit natyror të lëngëzuar**

1. Subjekti, që kryen veprimtari të gazit natyror dhe/ose çdo person tjetër juridik në aktivitetet e gazit natyror është i detyruar të sigurojë mbikëqyrje dhe inspektim të papenguar për përfaqësuesit e strukturës së gazit në ministri apo të inspektorëve të inspektoratit shtetëror përgjegjës për gazin, t’i lejojë atë/ata për të hyrë në objektet dhe t’u vërë në dispozicion të gjitha informatat e nevojshme, dokumentet dhe raportet e nevojshme për realizimin e mbikëqyrjes e të inspektimit.

2. Subjektet që kryejnë veprimtari të gazit dhe përdoruesit e sistemit të gazit janë të detyruar të veprojnë sipas kërkesës apo urdhrat të lëshuar nga autoriteti inspektues, i përcaktuar në kreun VI të këtij vendimi dhe, në veçanti, duhet:

a) Të mundësojnë kryerjen e mbikëqyrjes dhe inspektimit;

b) Të sigurojnë informacion për dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për mbikëqyrjen;

c) Të sigurojnë kushtet e nevojshme për përcaktim të gjendjes faktike;

ç) Të mundësojnë, në afatin e përcaktuar, aksesin në objektet, produktet ose çfarëdo dokumentesh të tjera, që janë objekt i inspektimit;

d) Të ndërpresin veprimtarinë gjatë mbikëqyrjes apo inspektimit, në bazë të kërkesës me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës apo inspektues, vetëm kur, sipas të dhënave korrente që disponohen, instalimet e gazit rezultojnë jo brenda parametrave teknikë të operimit të sigurt gjatë funksionimit të tyre, me qëllim kryerjen e mbikëqyrjes apo inspektimit dhe përcaktimin e gjendjes faktike;

dh) T’i paraqesin inspektorit ose të përgatisin të dhëna të sakta e të plota, raporte, materiale apo dokumente të tjera të nevojshme, me qëllim kryerjen e inspektimit, bazuar në kërkesën me shkrim dhe brenda një afati të përcaktuar në kërkesën e organit të inspektimit.

3. Subjekti që kryen veprimtari të gazit natyror, një person juridik dhe sipërmarrës, që është udhëzuar me vendim të inspektorit të mënjanojë të metat dhe parregullsitë, do të jetë i detyruar të informojë me shkrim inspektorin rreth korrigjimit të defekteve dhe parregullsive brenda afatit të specifikuar në vendim.

## **X. Procedimi, në rast moszbatimi të kërkesave ligjore**

1. Nëse inspektori nga inspektorati shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit, gjatë kryerjes së inspektimit identifikon se dispozitat e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të këtij vendimi, të rregulloreve të tjera, rregullave, standardeve, specifikimeve teknike dhe normave të cilësisë nuk kanë qenë në përputhje me përcaktimet dhe vlerat përkatëse ose janë zbatuar në mënyrë të papërshtatshme, miraton një vendim, me anë të të cilit:

a) Urdhëron riparimin e mangësive të identifikuara, të cilat ndikojnë negativisht në funksionimin e impianteve e të pajisjeve dhe përcakton afatin për këtë riparim;

b) Ndalon përdorimin e objektit, të impiantit, pajisjes ose instalimit, kur subjekti nuk ka arritur të riparojë parregullsitë e identifikuara brenda afatit të caktuar;

c) Ndalon përdorimin ose ndërtimin e objektit, të impiantit, pajisjes ose instalimit derisa parregullsitë e identifikuara të jenë riparuar.

2. Në rast të përsëritjes së shkeljeve, sipas pikës 1 të këtij neni, inspektori propozon vendosjen e sanksioneve, sipas përcaktimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

3. Inspektorati njofton ministrinë për shkeljet, sipas pikave 1 e 2 të këtij kreu, informon Entin Rregullator të Energjisë për vendimin e marrë dhe, në rast mosrespektimi të masave të përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij kreu, kërkon heqjen e licencës së veprimtarisë së gazit.

## **XI. Dispozita të fundit**

1. Në rast kundërshtimi nga subjekti të rezultateve të mbikëqyrjes apo inspektimit, ai ka të drejtë ankese kundër vendimit të inspektorit të gazit natyror, ankesë që do të dorëzohet në ministri, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes.

Ankesa kundër vendimit të përmendur në paragrafin e parë, të kësaj pike, nuk do të ndikojë në zbatimin e vendimit.

2. Subjekti ka të drejtën e ankimit edhe sipas ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**